


ZGJIDH DILEMAT



DUKE VOTUAR

ZHVILLIMI I POPULLIT ME ANË TË DEMOKRACISË

ERON (12), ARDIT (11), ERDI (11), ELSA (12), GERTA (12), ELIRA (11), PETRIT (12), LAVDON (11),
QËNDRESA (12), ARVANIT (12)

E drejta e votës, e drejta e shprehjes së lirë, e drejta e familjes, e drejta e shkollimit, janë vetëm disa nga të drejtat e shumta që ne i gëzojmë në demokraci



Demokracia është kaq e bukur. Ne si qytetarë gëzojmë shumë të drejta në këtë sistem të qeverisjes. Andaj, duhet të punojmë për zhvillimin e saj

Qytetarë të dashur, a e dini se si demokracia e ndihmon zhvillimin e popullit? Këtë do ta mësoni në artikullin në vijim

Sot jemi pjesë e projektit më të njohur për demokracinë „Demos-ti“. Që nga momenti që kemi ardhur këtu, gjatë tërë kohës nga edukatorët është diskutuar për demokracinë dhe vlerat e saj. Në kohën kur filluam të pajisemi me kartela identifikuese të „Demos-ti“ ose me bexha, edukatorja na pyeti se si t'i shpërnda-

edukatorëve. Vërtet u ndjemë shumë mirë ku të gjithë tashmë zotëronim nga një bexh. Një veprim kaq i vogël, kishte rëndësi shumë të madhe për të kuptuar se çka do të thotë të jetosh në bazë të parimeve të demokracisë. Përveç barazisë ne kishim rastin të mësonim për rëndësinë e vlerave të tilla si: respekti, toleranca, solidariteti, paqja, liria e të shprehurit, etj. Andaj, si grup reflektuam shumë sesa me fat jemi që e kemi këtë sistem të qeverisjes. Duke e menduar në mënyrë të detajuar këtë sistem, arritëm ta kuptojmë se pa kontributin dhe përkushtimin e qytetarëve, ndërtimi i mëtutjeshëm i demokracisë nuk do të ishte i mundur. Nëse sot kemi këtë nivel të demokracisë, është pikërisht falë punës dhe përkushtimit të qytetarëve aktiv. Prandaj, në artikullin në vazhdim do të mund t'i shihni disa nga iniciativat dhe punët që bëjnë qytetarët aktiv për ta zhvilluar edhe më tutje sistemin demokratik të qeverisjes.



Demokracia është shpresa ime


jme këta bexha në mënyrë që ky proces të jetë sa më demokratik. Fillimisht, sugjerimi ynë ishte që vetëm vajzave t'iu jepen bexhat, meqenëse, shpeshherë kemi dëgjuar se vajzat duhet të kenë përparësi. Ideja jonë nuk ishte edhe shumë e drejtë. Kjo sepse edukatorët na treguan se në demokraci nuk duhet të bëjmë dallime. Të gjithë duhet të trajtohemi në mënyrë të barabartë. Edhe ne u pajtuam me këtë mendim të



Së bashku për një demokraci me nivel të lartë



Ne informatat e mësuarat i ndajmë edhe me të tjerët, në mënyrë që të bëjmë një botë edhe më të mirë



Gjithçka nis me një ide. Të bashkuar dhe me përkushtim mund ta bëjmë realizimin e idesë sonë



Qytetarët aktiv kujdesen për ambientin ku ata jetojnë. Kjo dëshmon se kanë shumë dëshirë që t'iu sigurojnë edhe të tjerëve një jetë të shëndetshme dhe të lumtur



Një kontribut i vogël sjell ndryshim të madh



Respektimi i parimeve të demokracisë na bën të jemi aktiv

PËRFAQËSUESIT TANË ZGJIDHIN PROBLEME

LEDION (11), ORGESA (11), BLEART (11), DONIKA (11), ANTIK (11), HABIBE (11), RAMË (11), ALBIN (11),
AGNESA (11)



Zgjidhja e problemeve, vjen si rrjedhojë e zgjedhjes sonë të duhur

Jemi në stinën e dimrit, stinë e cila ka bukurinë e saj me bardhësinë e borës.

Përveç bukurive dhe kënaqësisë që na jep kjo stinë, ne hasim edhe në shumë probleme. Bllokimi i rrugëve është një shqetësim i qytetarëve të komunës sonë, pra komunës së Skenderajit. Atëherë, kur bie borë e madhe, neve si qytetarë, na pamundësohet lëvizja qoftë me mjete transportuese publike, qoftë me vetura private. Problem tjetër gjatë kësaj stine është edhe ngrirja e ujit, e cila na shkakton dëme të mëdha si në shtëpitë tona, ashtu edhe në shkolla. Gjithashtu, ekzistojnë edhe probleme të tjera, të cilat na paraqiten gjatë stinëve të ndryshme. Për shembull, gjatë vjeshtës, për shkak të reshjeve të mëdha të shiut lumi i fshatit Kozhicë del nga shtrati.

Pa dyshim se qytetarët e këtij fshati pësojnë dëme të mëdha. Çështje tjetër shqetësuese e cila ndodh gjatë stinës së verës, është se në fshatrat e Skenderajit nuk kemi ujësjellës dhe ne shërbehemi vetëm nga pusi. Ne kemi bërë një kërkesë drejtuar kryetarit tonë të Komunës, që ta rregulloj këtë çështje. Kjo për shkak se siç e dijme komuna është përgjegjëse për zgjidhjen e problemeve të tilla. Arsyeja pse ne i drejtohemi komunës është sepse ne vetë e zgjedhim kryetarin e komunës



sonë. Këto zgjedhje quhen zgjedhje lokale. Por, përveç zgjedhjeve lokale, kemi edhe zgjedhje qendrore, prej të cilave zgjedhen deputetët e Kuvendit të Kosovës. Deputetët janë përgjegjës për një mori çështjesh tjera të cilat e preokupojnë gjithë shtetin tonë. Zgjedhjet të cilat ne i përmendëm janë zgjedhje për të cilat qytetarët duhet të mendohen mirë para se të votojnë, sepse ata përfaqësues duhet të gjejnë zgjidhje për të gjitha problemet tona. Mandati i deputetëve dhe kryetarëve të komunave zgjat 4 vjet. Edhe ne si qytetarë të përgjegjshëm, kur të arrijmë moshën 18 vjeçare, do të marrim pjesë në zgjedhje. Mirëpo, para se të votojmë do të vendosim me kujdes se kush e meriton votën tonë. Është e drejtë e secilit prej neve të ankojemi për problemet e komunës apo shtetit tonë, prandaj edhe duhet të dalim dhe të votojmë për më të mirët.



Ne kemi zgjedhur për sot të jemi gazetarë të demokracisë

SHTËPIA E VENDIMEVE

LEONITA (12), DONJETA (12), EGLANTINA (11), EDONIS (11), ARIAN (11), EDISON (11), LEONIT (11),
ISUF (11), FATJON (11)



Në këtë artikull ne vendosëm që të imagjinojmë veten sikur jemi deputetë. Këtë e bëmë për shkak se dëshirojmë të ilustrojmë sa më mirë rolin e deputetëve. Ne shpresojmë se ju do të mësoni nga puna jonë

Përshëndetje për ju lexues. Sot në Punëtorinë e Demokracisë ne kemi mësuar dhe diskutuar për Kuvendin. Për këtë arsye, sot kemi marrë përsipër rolin e



deputetëve. Në shtetin tonë funksionon demokracia. Ajo është forma e udhëheqjes së shtetit tonë. Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke pasi që ka lindur në Greqi. Ne e dëgjojmë shumë shpesh fjalën demokraci. E dëgjojmë në televizion, në rrjete sociale, në bisedat e qytetarëve, etj. Mirëpo, sa herë që e dëgjojmë këtë fjalë na bie ndërmend: barazia gjinore, barazia etnike, barazia fetare. Na bien ndërmend të drejtat tona të cilat janë: e drejta e mendimit të lirë, e drejta e votimit

etj. Neve si grup, e drejta e votimit na pëlqen shumë. Ne si deputetë zgjedhemi pikërisht nga votat e qytetarëve. Në Kuvendin e Kosovës jemi 120 deputetë. Prej tyre 10 janë serbë dhe 10 të tjerë janë të komuniteteve jo shumicë. Kurse, 100 janë të kombësisë shqipëtare. Detyrat tona janë të zgjedhim Kryetarin e Kuvendit, të votojmë për kabinetin qeveritar, më saktë Kryeministrin dhe ministrat. Ne gjithashtu zgjedhim Presidentin e vendit. Më pas, ne kemi për detyrë të kontrollojmë punën e Qeverisë. Ky quhet funksioni kontrollues. Ne gjithashtu miratojmë ligje. Në muajin e ardhshëm do ta vëmë në votim një ligj për shëndetësi. Dëshirojmë që ta arrijmë një marrëveshje me të gjitha spitale të publike, ashtu edhe private të Kosovës. Kjo marrëveshje do t'u mundësonte fëmijëve dhe të moshuarve shërbime shëndetësore, pa pagesë. Kjo është detyra dhe privilegji ynë: mirëqenia e qytetarëve.



Deputetët e rinj të mbledhur rreth njëri-tjetrit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Dëshmorët e Qyqavicës“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Çirez, Skenderaj